

VENDIM
Nr. 135, datë 5.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 73, DATË 5.2.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021,
MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR
ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 1 dhe 2, të vendimit nr.73, datë 5.2.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi prej 1 457 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, i cili detajohet, si më poshtë vijon:

- a) 931 000 000 (nëntëqind e tridhjetë e një milionë) lekë në zërin “shpenzime korrente”.
- b) 526 000 000 (pesëqind e njëzet e gjashtë milionë) lekë në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”.

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet:

a) Në masën 1 000 000 000 (një miliard) lekë, nga fondi rezervë për zgjedhjet, miratuar për vitin 2021;

b) Në masën 457 000 000 (katërqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme, miratuar për vitin 2021.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama